

---

# 1 HYRJE

COBISS/Katalogimi është moduli kryesor i programit COBISS, i cili mbështet katalogimin e përbashkët në kuadër të sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Moduli COBISS/Katalogimi është i lidhur me modulet e tjera të programit dhe mundëson që të dhënat e njëjta të përdoren për qëllime të ndryshme.

Për të bashkëpunuar në sistemin e përbashkët të katalogimit, përveç njohurive rreth programit për katalogim, janë të domosdoshme edhe njohuritë rreth formateve COMARC dhe UNIMARC, standardeve të ISBD-së, si dhe rregullat për katalogimin dhe përpunimin e përmbajtjes së materialeve të bibliotekës.

Në këtë manual gjenden udhëzime të hollësishme për përdorimin e programit COBISS3/Katalogimi. Manuali është përgatitur për kataloguesit, të cilët punojnë me programin COBISS.

Përmbajtja e këtij manuali është e ndarë në 15 kapituj dhe 9 shtojca.

Pas hyrjes, në kapitullin e dytë, është përshkruar sistemi i përbashkët i katalogimit.

Në tre kapitujt në vazhdim janë përshkruar elementet e programit COBISS3: ndërfaqja për katalogim, dritarja për kërkim dhe paraqitësi. Në kapitujt gjashtë dhe shtatë është përshkruar kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve dhe redaktuesi i regjistrimit, të cilët formojnë ndërfaqen për katalogim.

Në kapitullin e tetë janë dhënë udhëzimet e përgjithshme në lidhje me katalogimin në sistemin COBISS, ndërsa procedurat me regjistrimet bibliografike janë përshkruar më vete.

Në kapitullin e nëntë janë përshkruar parimet e katalogimit me kontrollin e njësuar, veçoritë në funksionimin e komponentëve të modulit COBISS3 /Katalogimi në klasën **Regjistrimi i njësuar (CONOR)**, si dhe veprimet me regjistrimet e njësuara.

Në kapitullin e dhjetë janë përshkruar veçoritë e lidhura me kontrollin e njësuar të emërtimeve lëndore dhe veçoritë në funksionimin e komponentëve të modulit COBISS3/Katalogimi në klasën **Regjistrimi i njësuar (SGC)**.

Në kapitullin e njëmbëdhjetë janë përshkruar regjistrimet e ruajtura përkohësisht.

Në kapitullin e dymbëdhjetë janë përshkruar veprimet me regjistrimet bibliografike dhe termat e njësuar, si dhe regjistrimet nga baza CORES në shfletues.

Kapitulli i trembëdhjetë përmban përshkrimin e regjistrimeve në disa lloje shkrimesh.

Parametrat e përdoruesve janë përshkruar në kapitullin e katërbëdhjetë, ndërsa lidhjet e modulit COBISS3/Katalogimi me modulet e tjera të programit COBISS në kapitullin e fundit të këtij manuali.

Pjesë e rëndësishme e manualit janë shtojcat nga A deri në I:

- indokset për kërkim
- kontrollet automatike
- METADAT
- lista e shkurtoreve për aplikimin e disa procedurave dhe metodave
- atributet për shfaqjen e listës së rezultateve të kërkimit
- regjistrimet e shkarkuara nga bazat e tjera të të dhënave
- CORES
- bibliografitë nga lista e emërtimeve lëndore
- formatet e përdoruesit për bibliografitë